



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

2013

RAPORT I MONITORIMIT TË KUVENDEVE TË KOMUNAVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS



DLMK

Divizioni për Monitorim të Komunave

4/15/2013



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Raport

I MONITORIMIT TË KUVENDEVE TË KOMUNAVE TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS

Janar-Mars 2013

Prishtinë, Prill 2013

PËRMBAJTJA

- Hyrje
- Qëllimi
- Përmbledhje ekzekutive
- Mbledhjet e mbajtura
- Aktet komunale
- Transparenca
- Shqyrtimi administrativ i akteve komunale
- Këshilli komunal për siguri në bashkësi
- Pjesa e veçantë
- Shkeljet ligjore
- Rastet e rishqyrtimit të akteve nga komunat
- Konkluzionet
- Rekomandimet e përgjithshme

Hyrje

Në përputhje me përgjegjësitë ligjore dhe mandatin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave, përmes Divizionit të Monitorimit të Komunave, edhe gjatë periudhës janar-mars 2013 ka mbikëqyrë veprimtarinë e Kuvendeve të Komunave të Republikës së Kosovës.

Pikësynim kryesor i këtij procesi ka qenë monitorimi i punës së Kuvendeve të Komunave dhe ofrimi i informatave tek mekanizmat përgjegjës me qëllim të sigurimit që veprimtaria e Kuvendeve të Komunave të jetë në harmoni me dispozitat juridike të legjislacionit në fuqi. Shkeljet e evidentuara janë adresuar në Departamentin Ligjor dhe Monitorim të Komunave/MAPL, si dhe në komisionet sektoriale për shqyrtim dhe procedim të mëtejme rasteve sipas kornizës ligjore.

Ky raport, është me rëndësi të shumanshme dhe nënvizon të dhëna të rëndësishme për mënyrën e funksionimit të kuvendeve të komunave, duke paraqitur detaje të mjaftueshme për të ngritur një paralele në mes komunave dhe t'i rendis ato sipas mënyrës së funksionimit dhe nivelit të respektimit të legjislacionit në fuqi.

Paraqitja e aktiviteteve të kuvendeve të komunave është gjithashtu mekanizëm i rëndësishëm i vënies së përgjegjësive të komunave para qytetarëve dhe institucioneve publike.

Qëllimi

Qëllimi i raportit është të krijojmë informim të drejtë për qytetarët lidhur me aktivitetet e të zgjedhurve të tyre lokal. Raporti shërben si një mjet për të rritur transparencën e Komunave gjatë ushtrimit të aktiviteteve dhe kryerjes së përgjegjësiave të tyre. Në raport janë përfshirë të dhëna të përgjithshme rreth funksionimit të Kuvendeve të Komunave. Po ashtu, përfshihen edhe gjetjet më të rëndësishme të evidentuara gjatë kësaj periudhe. Raporti është hartuar në pjesë të ndara, duke përfshirë nga katër, pesë ose gjashtë komuna në grupe, varësisht nga numri i komunave që monitorojnë zyrtarët përgjegjës.

Në kuadër të raportit, përfshihen të dhëna për 34 komuna të Republikës së Kosovës, ndërkohë për Komunën e Leposaviqit, Zveçanit dhe Zubin Potokut nuk kemi të dhëna zyrtare marr parasysh pamundësinë e monitorimit të këtyre komunave, ashtu siç është përcaktuar me legjislacionin për vetëqeverisje lokale në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Edhe në periudhën janar-mars të vitit 2013 kuvendet e komunave kanë zhvilluar me rregull punën e tyre në ushtrimin e përgjegjësive të cilat burojnë nga legjislacioni bazë për vetëqeverisje lokale, si dhe ligjet e tjera specifike të cilat implikojnë përgjegjësi për organet e vetëqeverisjes lokale. Në komuna është vazhduar me zhvillimin dhe planifikimin e aktiviteteve, orarin e takimeve, në miratimin e planeve vjetore të punës dhe të çështjeve të tjera me rëndësi të përgjithshme. Në këtë zhvillim, kontribut të theksuar kanë dhënë edhe organet e nivelit qendror. Më konkretisht, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka luajtur rol konstruktiv, duke kontribuar në zhvillimin e proceseve të ndryshme dhe në avancimin e vetëqeverisjes lokale. Nevoja për të mbikëqyrë punën e organeve të vetëqeverisjes lokale mbetet rëndësi imediate për komunat dhe proceset administrative në përgjithësi.

Pjesa ekzekutive e raportit nënvizon aspektet e përgjithshme të funksionimit të komunave, duke u fokusuar në veprimtarinë e Kuvendeve të Komunave, Komiteteve, përkatësisht mbledhjeve të mbajtura, akteve të miratuara, raportit në mes të komunave dhe organit mbikëqyrës, shkallën e respektimit të legjislacionit në fuqi, numrin e shkeljeve ligjore, nivelin e respektimit dhe harmonizimin e veprimeve që rrjedhin nga provizionet ligjore, transparencën si dhe funksionimin e Këshillave Komunale për Siguri në Bashkësi (KKSB).

Gjatë periudhës janar-mars 2013, në Republikën e Kosovës kanë qenë funksionale 34 kuvendet e komunave. Mbledhjet e kuvendeve të komunave janë monitoruar përmes sistemit të teleprezencës. Sistemi në fjalë ka mundësuar një lidhje të drejtpërdrejtë me kuvendet e komunave. Mbledhjet janë mbajtur rregullisht dhe sipas raporteve të monitorimit, të gjitha komunat kanë përmbushur kriteret e nevojshme sa i përket numrit të takimeve të kuvendeve të komunave. Mbledhjet e Kuvendeve të Komunave kanë qenë të hapura për publikun, ndërsa me qëllim të rritjes së transparencës komunale, në shumicën e komunave është mundësuar transmetimi direkt dhe indirekt i mbledhjeve, në televizionet lokale, ose në ueb-faqen e komunës përmes aplikacioneve të sistemit të teleprezencës e cila mundëson transmetime të tilla. Sa i përket mbarëvajtjes së mbledhjeve të kuvendeve dhe funksionimit të punës së tyre, komunat në një masë të madhe kanë respektuar ligjet e aplikueshme të Republikës së Kosovës.

Gjatë kësaj periudhës Kuvendet e Komunave të Republikës së Kosovës kanë mbajtur gjithsej 95 mbledhje të rregullta, ndërsa kanë mbajtur edhe 6 mbledhje të jashtëzakonshme. Po që se krahasojmë të dhënat e mbledhjeve të kuvendeve me periudhën janar-mars të vitit 2012 me atë të vitit 2013, atëherë numri i përgjithshëm tregon për aktivitet pothuajse të njëjtë në mbajtjen e mbledhjeve të kuvendeve të Komunave. Në vijim është paraqitur numri i përgjithshëm i krahasuar në mes të periudhës së njëjtë të vitit 2012 me atë të vitit 2013:

**Mbledhjet e Kuvendeve të Komunave në periudhën janar-mars
2012 dhe janar-mars 2013**




Fig.1 *Krahasimi i të dhënave për numrin e mbledhjeve të kuvendeve të komunave të mbajtura gjatë periudhës janar-mars të vitit 2012 me periudhën janar-mars të vitit 2013*

Paralelisht me Kuvendet e Komunave janë mbledhur edhe komitetet e obligueshme. Edhe pse me LVL të dy komitetet janë të obligueshme, Komunitetet më pak i japin rëndësi Komitetit për Komunitete. Për nga numri, Komitetet për Politikë dhe Financa kanë mbajtur gjithsej 103 mbledhje, ndërkaq Komitetet për Komunitete janë mbledhur 69 herë. Për dallim nga Komiteti për Politikë dhe Financa i cili ka qenë funksional në të gjitha komunat, Komiteti për Komunitete nuk ka qenë aktiv në komunat: Kaçanik, Graçanicë, Shtërpçë, Ranillg, Partesh dhe Kllokot.

Megjithatë, nëse shikojmë të dhënat e akteve të miratuara gjatë kësaj periudhe, do të shihet se Kuvendet e Komunave kanë miratuar 369 vendime dhe 42 rregullore. Më poshtë është paraqitur figura krahasuese me të dhënat për numrin e akteve të miratuara në periudhën janar-mars 2012 dhe janar-mars 2013:

Të dhënat krahasimore për numrin e akteve të miratuara në vitin periudhën janar-mars 2012 dhe janar-mars 2013




Fig.2 Krahasimi i të dhënave për numrin e akteve të miratuara gjatë periudhës janar-mars të vitit 2012 me periudhën janar-mars të vitit 2013

Pra, siç shihet nga figura e mësipërme, Kuvendet e Komunave kanë zhvilluar aktivitetin e tyre ngjashëm me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Pjesa më e madhe e akteve të miratuara gjatë kësaj periudhe, i përket akteve të cilat rregullojnë materie të shumta, duke përfshirë: akte të karakterit financiar, akte që rregullojnë procedurat për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme, vendime për themelimin e komisioneve për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, vendime për ndërrimin e destinimit të pronave, shpallje të zonave me interes të përgjithshëm, vendime për emërtimin e rrugëve, akte nga sfera e shërbimeve publike, akte që rregullojnë organizimin e brendshëm të administratës së komunave, akte që rregullojnë krijimin e të hyrave komunale, krijimin e mekanizmave komunal për siguri në bashkësi etj.

Këto akte janë pjesë e obligimeve ligjore të komunave dhe kërkohet të jenë në harmoni të plotë me legjislacionin në fuqi. Mirëpo, nisur nga ky aspekt, jo gjithëherë komunat u janë përmbajtur rregullave ligjore me rastin e hartimit dhe nxjerrjes së vendimeve apo rregulloreve të caktuara komunale. Gjatë kësaj periudhe, nga Divizioni i Monitorimit janë identifikuar 10 akte të kundërligjshme të cilat janë miratuar në Kuvendet e Komunave, si dhe 15 raste të evidentuara nga komisionet ndërministrorë. Në vijim, në formë grafike është paraqitur numri i akteve të kundërligjshme të vlerësuara nga MAPL, atyre ndaj të cilave është bërë shkresë për rishqyrtim, numri i akteve të rishqyrtuara nga komunat si dhe numri i akteve të cilat pas rishqyrtimit të tyre janë ndryshuar sipas rekomandimeve të organit mbikëqyrës:

Rishqyrtimi i akteve komunale të kërkuara nga MAPL




Fig. 3 Figura me të dhënat për procesin e rishqyrtimit të akteve të kundërligjshme të vlerësuara nga MAPL

Komunat në të cilat janë shfaqur raste të shkeljeve ligjore janë: Obiliqi (1 vendim), Kaçaniku (1 shkelje procedurale me rastin e mbajtjes së mbledhjes së jashtëzakonshme, Ranillugu (2 vendime), Prizreni (4 vendime), Rahoveci (1 vendim të kundërligjshëm dhe 1 shkelje procedurale me rastin e nxjerrjes së vendimit). Për të gjitha këto raste, MAPL është drejtuar me shkresë për rishqyrtimin e tyre dhe respektimin e legjislacionit në fuqi, mirëpo asnjëra nga këto komuna nuk ka kthyer për rishqyrtim aktet e supozuara të kundërligjshme. Prej këtyre rasteve, vetëm Komuna e Obiliqit e ka kthyer një vendim për rishqyrtim mirëpo duke mos vepruar konform rekomandimeve të MAPL-së. Ndërkaq, prej vendimeve të cilat janë miratuar në vitin 2012 për të cilat janë konstatuar shkelje ligjore, në vitin 2013 Komuna e Rahovecit i ka rishqyrtuar dy akte të tilla (të cilat i ka shfuqizuar), si dhe një vendim Kuvendi i Komunës së Gjakovës, të cilin e ka harmonizuar me rekomandimet e MAPL-së.

Ndërkaq, komisionet ndërministrrore kanë konstatuar shkelje ligjore për këto komuna: Malishevë (1 rregullore), Shtime (1 rregullore), Vushtrri (1 rregullore), Rahovec (1 Rregullore), Gjakovë (2 vendim), Istog (1), Ferizaj (1 vendim), Mitrovice (1 vendim dhe 1 rregullore), Kllokot (1 vendim), Prishtine (1 vendime), Gjilan (1 vendim), Pejë (1 Rregullore).

Në vijim, në formë grafike është paraqitur numri i akteve të kundërligjshme të vlerësuara nga komisionet përkatëse ndërministrrore, atyre ndaj të cilave është bërë shkresë për rishqyrtim, numri i akteve të kthyera për rishqyrtim, si dhe numri i akteve të cilat janë rishqyrtuar dhe ndryshuar sipas rekomandimeve të komisioneve sektoriale:

Rishqyrtimi i akteve komunale të kërkuara nga Komisionet ndërministrorë




Fig. 4 Figura me të dhënat për procesin e rishqyrtimit të akteve të kundërligjshme të vlerësuara nga komisionet ndërministrorë

Prej këtyre rasteve, 1 vendim është kthyer për rishqyrtim në Komunën e Gjakovës mirëpo duke mos vepruar sipas vlerësimeve të komisionit, 1 Rregullore në Komunën e Istogut e cila është harmonizuar sipas rekomandimeve të komisionit dhe një Rregullore në Komunën e Vushtrrisë e cila është harmonizuar gjithashtu sipas rekomandimeve të komisionit.

Në këtë segment, për të evituar jo-ligjshmërinë, me LVL është përcaktuar se “aktet e përgjithshme të Kuvendit të Komunës duke përfshirë edhe vendimet i nënshtrohen shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë”, e cila është formë e veçantë e autorizimeve kontrolluese që autoriteti mbikëqyrës ushtron ndaj akteve të përgjithshme komunale. Për të mundur këtë proces, komunat janë të obliguara që aktet normative nënligjore t’i dërgojnë në organin mbikëqyrës për vlerësim të ligjshmërisë së tyre. Në këtë periudhë, obligimit ligjor për dërgimin e akteve komunale për vlerësim të ligjshmërisë nuk i janë përmbajtur komunat: Rahovec, Deçan, Prishtinë dhe Kamenicë.

Aspekt tjetër i rëndësishëm për t’i përmbledhur në këtë pjesë të raportit është edhe fusha e sigurisë së përgjithshme të qytetarëve. Si mekanizëm për trajtimin e kërkesave të qytetarëve në raport me sigurinë publike, Ligji për Policinë, ka paraparë themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi. Me Udhëzimin Administrativ Nr.27/2012 MPB - 03/2012 MAPL për KKSBB është përcaktuar numri prej gjashtë mbledhjeve brenda vitit të këtij mekanizmi. Sipas të dhënave, këto këshilla në këtë periudhë kanë mbajtur gjithsej 30 takime. Në këtë kuadër, komunat të cilat nuk kanë mbajtur asnjë takim të KKSBB-së janë: Gjalani, Peja, Mamusha, Gjakova, Deçani, Graçanica, Parteshi, Ranillugu dhe Shtërpca.

KOMUNAT: PRISHTINË, GJILAN, PRIZREN, PEJË, KAMENICË, DHE NOVOBËRDË

Mbledhjet e mbajtura

Raporti për funksionimin e organeve të komunave: Prishtinë, Gjilan, Prizren, Pejë, Kamenicë dhe Novobërdë, pasqyron gjendjen reale dhe procesin e punës për këtë periudhë raportues.

Për nga aspekti kuantitativ i mbajtjes së mbledhjeve të kuvendit, kuvendet e komunave e kanë përmbushur këtë obligimin ligjor, si dhe me kohë e kanë njoftuar MAPL-në për mbajtjen e tyre, duke respektuar procedurat dhe afatet e njoftimeve. Ndërsa, për nga aspekti kualitativ i punës, në komuna vërehet një gatishmëri dhe përkushtim në çështjen e respektimit të procedurave dhe procesit të punës duke respektuar Rregulloren e Punës së Kuvendit.

Nga këndvështrimi numerik, gjatë periudhës janar – mars të vitit 2013, kuvendet e komunave kanë mbajtur gjithsej 18 mbledhje, prej të cilave 17 mbledhje të rregullta dhe 1 të jashtëzakonshme.

Në vijim është paraqitur skema grafike e mbledhjeve të mbajtura të kuvendeve të këtyre komunave:




Fig.5. Numri i mbledhjeve të kuvendeve të komunave: Prishtinë, Gjilan, Prizren, Pejë, Kamenicë dhe Novobërdë³

Nga figura e mësipërme shihet se Kuvendi i Komunës së Prishtinës dhe Gjilanit kanë mbajtur numrin më të madh të mbledhjeve me nga 4 mbledhje të kuvendit, duke pasuar me Kuvendin e Komunës së Kamenicës me 3 mbledhje të mbajtura, Kuvendin e Komunës së Pejës dhe Novobërdës me nga 2 mbledhje të rregullta, si dhe Kuvendin e Komunës së Prizrenit me 2 mbledhje të rregullta dhe 1 të jashtëzakonshme.

Në periudhën janar–mars 2013, në Komuna është i dukshëm organizimi i aktiviteteve, duke përfshirë numrin e takimeve, miratimin e planeve vjetore të punës, krijimin dhe ofrimin e klimës për zhvillimin e debateve në mes të kuvendarëve, miratimin e akteve të shumta, si dhe çështje të tjera. Në këto komuna, pothuajse në shumicën e rasteve, mbledhjet kanë filluar dhe janë zhvilluar në bazë të planit të paraparë, me përjashtim të disa rasteve kur rendi i ditës është plotësuar me kërkesë të anëtarëve të kuvendit. Vlen të përmendet se gjatë kësaj periudhe raportuese janë evidentuar disa raste të kalimeve të anëtarëve të kuvendit nga njëri subjekt politik në subjektin tjetër, me dhënie të dorëheqjes nga pozita e anëtarit të kuvendit, si dhe kalimin nga subjekti politik në cilësinë e anëtarit të pavarur të kuvendit, në komunat: Prishtinë dhe Gjilan.

Të gjitha mbledhjet e kuvendeve të komunave kanë qenë të hapura për publikun, ndërkaq me qëllim të rritjes së transparencës komunale, në shumicën e komunave është mundësuar transmetimi direkt apo indirekt i mbledhjeve nga televizionet lokale. Po ashtu, duhet theksuar se Komunat, informimin e bëjnë edhe përmes ueb-faqes zyrtare komunale, buletinit, informimit publik, nxjerrjes së përmbledhjeve të akteve komunale. Prezenca e përfaqësuesve nga organizatat ndërkombëtare dhe vendore ka qenë e theksuar në shumicën e mbledhjeve të kuvendeve të komunave .

Krahas punës së kuvendeve të komunave, në këtë periudhë Komitetet obligative dhe komitetet e tjera kanë qenë funksionale. Numri i mbledhjeve të këtyre trupave është paraqitur si në vijim:




Fig.6. Numri i mbledhjeve të Komiteteve të obligueshme: Prishtinë, Gjilan, Prizren, Pejë, Kamenicë dhe Novobërdë

Nga figura e mësipërme vërejmë se në Kuvendin e Komunës së Prizrenit, KPF ka mbajtur 5 mbledhje, kurse KK 2 mbledhje, në Kuvendin e Komunës së Prishtinës, KPF ka mbajtur 4 mbledhje, ndërsa KK 3 mbledhje, në Gjilan dhe atë të Kamenicë, Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Komiteti për Komunitete kanë mbajtur nga 3 mbledhje, në

kuvendin e komunës së Pejës, KPF ka mbajtur 2 mbledhje, kurse KK 3 mbledhje, ndërsa në kuvendin e komunës së Novobërdës, KPF dhe KK kanë mbajtur nga 2 mbledhje.

Ndërsa, sa u përket akteve komunale, janë miratuar gjithsej 99 akte komunale, prej tyre 90 vendime dhe 9 rregullore. Aktet komunale të miratuara nga kuvendet e komunave, përfshijnë sfera të ndryshme dhe me rëndësi për qytetarët si: planet rregulluese urbane, dhënia në shfrytëzim dhe këmbim të pronës komunale, infrastruktura lokale, projekt programe për banim për raste sociale, projekt kapitale nga donatorët, plane komunale për menaxhimin e mbeturinave etj.




Fig.7. Numri i akteve komunale të miratuara në Kuvendet e Komunave: Prishtinë, Gjilan, Prizren, Pejë, Kamenicë dhe Novobërdë

Në miratimin e akteve komunale, më aktive është treguar Kuvendi i Komunës së Prishtinës me 23 vendime dhe 2 rregullore të miratuara, pasuar me Kuvendin e Komunës së Pejës me 20 akte të miratuara dhe Kamenicës poashtu me 20 akte komunale të miratuara, pastaj Kuvendi i Komunës së Gjilanit me 12 vendime dhe 2 rregullore të miratuara, Kuvendi i Komunës së Prizrenit me 10 vendime të miratuara, kurse Kuvendi i Komunës së Novobërdës me 9 vendime dhe 1 rregullore të miratuara.

Me qëllim të forcimit të transparencës dhe krijimit të hapësirës që qytetarët të jenë pjesë e vendimmarrjes, Komuna e Novobërdës ka mbajtur 1 takim publik me qytetare. Ndërsa, komunat tjera nuk kanë mbajtur asnjë takim publik me qytetarë.

Lidhur me Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, periudha janar – mars 2013 rezultoi me këto të dhëna:

KKSB




Fig.8. Numri i takimeve të KKSB-ve në komunat: Prishtinë, Gjiilan, Prizren, Pejë, Kamenicë dhe Novobërdë

Nga figura e mësipërme del që Komuna e Prishtinës, Prizrenit, Kamenicës dhe Novobërdës kanë mbajtur nga 1 mbledhje, ndërsa Komuna e Gjiilanit dhe Pejës nuk kanë mbajtur asnjë mbledhje.

Pjesa e veçantë

Në këtë pjesë të raportit janë pasqyruar disa nga të gjeturat e evidentuara në komunat e mëposhtme si dhe veprimet e komunave për evitimin e jo-ligjshmërisë:

Prishtinë

1) Për muajin janar të vitit 2013, Komuna e Prishtinës nuk ka bërë dërgimin e akteve komunale për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë në organin mbikëqyrës, ashtu siç është përcaktuar në nenin 80 dhe 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

Pas dërgimit të shkresës ligjore nga MAPL në adresë të Komunës së Prishtinës për mosdërgim të akteve komunale për shqyrtim të ligjshmërisë, Komuna e Prishtinës ka ndërmarrë hapat e duhur duke respektuar legjislacionin e zbatueshëm për vetëqeverisje lokale në Republikën e Kosovës, dhe me këtë duke bërë dërgimin e këtyre akteve, si dhe akteve të tjera komunale të miratuara në muajin shkurt dhe mars të vitit 2013 në MAPL.

2) Sa i përket vlerësimit të ligjshmërisë së akteve të miratuara për periudhën janar – mars 2013, komisioni sektorial, duke u bazuar në nenin 81.4 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligjin nr. 03/L-049 Financa të Pushtetit Lokal, ka konstatuar se në mbledhjen e mbajtur me datë 28.02.2013, Kuvendi i Komunës së Prishtinës ka miratuar Vendimin për plotësimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale me 01. nr. 110-2782 të dt. 02.12.2011. Ky vendim është në kundërshtim me

nenin 12 të Rregullores nr. 01/2013 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunave për faktin se zëvendësimi dhe plotësim - ndryshimi i akteve mund të bëhet. Lidhur me këtë rast, Komuna e Prishtinës ende nuk ka ndërmarrë veprimet e duhura.

3) Gjithashtu, Komisioni sektorial, duke u bazuar në nenin 81.4 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligjin nr.03/L-049 Financa të Pushtetit Lokal, ka konstatuar se Vendimi për taksat administrative për lëshimin e lejes së ndërtimit dhe tarifat për ndikimet nga rritja e dendësitetit të infrastrukturës për vitin 2013 me numër 01.Nr.016-30160 të miratuar nga kuvendi i komunës së Prishtinës në mbledhjen e mbajtur me datë 12.03.2013 është në kundërshtim me nenin 12 të Rregullores Nr. 01/2013 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunave sepse Rregullorja komunale shfuqizohet me vendim. Edhe në këtë rast, Komuna e Prishtinës ende nuk ka ndërmarrë veprimet e duhura.

Gjilan

1) Nga aktet e miratuara në Kuvendin e Komunës së Gjilanit, Komisioni sektorial ka pranuar për shqyrtim të ligjshmërisë: Vendimin për aprovimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale për vitin 2013. Bazuar në nenin 81.4 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligjin nr.03/L-049 Financa të Pushtetit Lokal, komisioni ka konstatuar se: Vendimi për aprovimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale për vitin 2013 të Komunës së Gjilanit është në kundërshtim me nenin 12 të Rregullores nr.01/2013 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunave. Komuna e Gjilanit ende nuk ka ndërmarrë veprimet e duhura për harmonizimin e aktit me rekomandimet e kërkuara.

Prizren

Në Komunën e Prizrenit, gjatë kësaj periudhë janë evidentuar 2 shkelje ligjore:

1) Raporti i Komisionit të përbashkët të dy ministrive MMPH-MAPL për mbikëqyrjen e ligjshmërisë së akteve të komunave nga fusha e banimit, lidhur me shqyrtimin e kërkesës për Vendimin për zgjidhjen e problemit të banimit për të gjitha familjet e dëshmorëve, të miratuar nga kuvendi i komunës së Prizrenit, e pranuar nga MAPL me nr. 0204-183/1 të dt.28.02.2013 ka konstatuar se në preambulën e Vendimit mungon referimi në bazën ligjore për zgjidhjen e problemit të banimit për të gjitha familjet e dëshmorëve, respektivisht:

Ligjit nr.03/L-164 për financimin e programeve të veçanta të banimit, Ligjit nr.04/L-054 për Statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre dhe Udhëzimit Administrativ nr.15/2012 për caktimin e kushteve dhe kriterëve për sigurimin e banimit familjar për invalidët dhe veteranët e UÇK-së dhe familjeve të dëshmorëve. Komuna ka përgjegjësi për hartimin e programeve tre vjeçare të banimit sipas nenit 20, Ligjit Nr.03/L-164 për financimin e programeve të veçanta të banimit, për qytetarët që kanë në juridiksionin e tyre, duke u mbështetur në analizën e nevojave për banim, sipas

mundësive buxhetore, të cilat miratohen nga kuvendi i komunës për të gjitha kategoritë me prioritet. Komuna duhet të respektoj të gjitha procedurat e legjislacionit përkatës në fuqi. Sa i përket vendimit në fjalë, Komuna e Prizrenit ende nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim konform rekomandimit të komisionit të përbashkët MMPH-MAPL.

2) Gjithashtu, MAPL ka vlerësuar edhe një vendim të kundërligjshëm nga mbledhja e Kuvendit të Komunës së Prizrenit të datës 15.11.2012. Vendimi i kundërligjshëm i datës 15.11.2012 është 1) Vendim për këmbimin e pronës publike të komunës me pronën private të PSH Euro-Invest. MAPL, ka kërkuar që vendimi në fjalë të harmonizohet me dispozitat ligjore të ligjit të ri në fuqi – me nenin 11, të Ligjit nr.04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës. Komuna nuk ka ndërmarrë veprim për harmonizimin e aktit.

Pejë

1) Prej akteve të miratuara në Kuvendin e Komunës së Pejës, nga Komisioni ndërministror është konstatuar një vendim i kundërligjshëm. Në mbledhjen e mbajtur me datë 06.03.2013, Kuvendi i Komunës së Pejës ka nxjerrë Vendimin për aprovimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoha komunale nr.06-1345. Komisioni sektorial, duke u bazuar në nenin 81.4 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligjin nr.03/L-049 Financa të Pushtetit Lokal, ka konstatuar se vendimi në fjalë është në kundërshtim me nenin 12 të Rregullores Nr.01/2013 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunave. Në këtë rast, Komuna e Pejës ende nuk ka ndërmarrë veprimet e duhura për të rishqyrtuar vendimin e lartpërmendur.

Kamenicë

1) Në çështjen e dërgimit të akteve komunale, Komuna e Kamenicës në muajin janar të vitit 2013, nuk ka bërë dërgimin e tyre për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë në organin mbikëqyrës, ashtu siç është përcaktuar në nenin 80 dhe 81 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

Pas dërgimit të shkresës ligjore nga MAPL në adresë të Komunës së Kamenicës për mosdërgim të akteve komunale për shqyrtim të ligjshmërisë, Komuna e Kamenicës ka filluar me dërgimin e akteve të miratuara duke përmbushur obligimin ligjor në këtë drejtim.

KOMUNAT: GJAKOVË, RAHOVEC, DEÇAN, JUNIK, ISTOG

Mbledhjet e mbajtura

Gjatë periudhës janar-mars 2013, Kuvendet e Komunave: Gjakovë, Rahovec, Deçan dhe Junik kanë zhvilluar me rregull punën e tyre. Nga aspekti numerik, kuvendet e këtyre komunave kanë mbajtur gjithsej 13 mbledhje të rregullta, ndërsa nëse i pasqyrojmë ndaras, numri i mbledhjeve të kuvendeve qëndron si në vijim:

Mbledhjet e Kuvendeve të Komunave




Fig.9 Numri i mbledhjeve të Kuvendeve të Komunave: Gjakovë, Deçan, Junik, Istog dhe Rahovec

Nga figura e mësipërme shihet që Komuna e Gjakovës, Deçanit dhe Istogut kanë mbajtur nga 3 mbledhje, përderisa Komuna e Junikut dhe Rahovecit kanë mbajtur nga dy mbledhje të rregullta. Nga të dhënat e mësipërme vërejmë se në këtë periudhë nuk është mbajtur asnjë mbledhje e jashtëzakonshme.

Lidhur me mbarëvajtjen e punës së kuvendeve, të gjitha mbledhjet e kuvendeve kanë qenë të hapura për publikun. Informimi i qytetarëve për mbledhjet e kuvendeve është bërë përmes ueb-faqeve zyrtare të komunave, shpalljeve të vendosura në objektet e komunave, televizioneve lokale dhe forma të tjera të informimit publik. Gjatë kësaj periudhe nuk është shënuar asnjë bojkotim i mbledhjeve nga kuvendarët e komunave, mirëpo janë shënuar disa raste të kalimeve individuale nga një subjekt politik në subjektin tjetër. Raste të tilla janë paraqitur në Gjakovë, Rahovec dhe Deçan. Këto lëvizje të anëtarëve të kuvendit nga një subjekt politik në tjetrin, në raste të caktuara kanë rezultuar me ndryshimin e përbërjes së komiteteve të obligueshme. Për më saktë, në rastin e Komunës së Rahovecit, për shkak të kalimit të anëtarit të kuvendit nga një subjekt politik në subjektin tjetër, kësaj ka ndryshuar edhe përfaqësimi i subjekteve politike në Komitetin për Politikë dhe Financa. Me gjithë këtë, kjo çështje nuk është ngritur si problem nga ana e subjektit përkatës politik, i cili për shkak të kësaj lëvizje ka mbetur i papërfaqësuar në KPF.

Sa u përket komiteteve të obligueshme (KPF-së dhe KK-së), këto komitete komunitete kanë qenë funksionale. Numri i përgjithshëm i mbledhjeve të këtyre komiteteve është 28, prej të cilave 15 i përkasin Komitetit për Politikë dhe Financa dhe 13 Komitetit për Komunitete. Në vijim janë pasqyruar të dhënat për mbledhjet e Komiteteve të Obligueshme veç e veç për secilën komunë:

Mbledhjet e Komiteteve të obligueshme




Fig.10. Numri i mbledhjeve të Komiteteve të obligueshme: Gjakovë, Deçan, Junik, Istog dhe Rahovec

Krahas asaj që u pasqyrua më lartë, në kuvendet e komunave janë miratuar një numër i akteve juridike nënligjore, përfshirë rregullore, vendime, plane të ndryshme dhe rekomandime. Nga pikëpamja kuantitative, Kuvendet e Komunave kanë miratuar në total 48 akte nënligjore, prej të cilave 39 vendime dhe 9 Rregullore. Më poshtë është paraqitur numri i akteve për secilën komunë:

Aktet komunale




Fig. 11. Numri i akteve komunale të miratuara në Kuvendet e Komunave: Gjakovë, Deçan, Junik, Istog dhe Rahovec

Nga figura e mësipërme shihet që në nxjerrjen e vendimeve më efikase është treguar Komuna e Gjakovës, ndërkaq më pak efikase Komuna e Junikut. Materia që rregullojnë aktet e nxjerra në këtë periudhë i përket fushës së mjedisit, akteve të natyrës financiare, bartje të mjeteve nga viti paraprak në vitin pasues, akteve të karakterit organizativ dhe funksional të komunës, themelimin e komisioneve për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme, dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, miratimit të përbërjeve të KKSB-ve etj.

Lidhur me përgjegjësitë e komunave për informim të drejtë të qytetarëve lidhur me aktivitetet e kuvendeve të komunave, në adresën zyrtare të komunave janë postuar informacione të përgjithshme kryesisht lidhur me aktivitetet e kryetarëve të komunave. Mirëpo, edhe gjatë kësaj periudhe nuk është vërejtur ndonjë progres i komunave në publikimin e akteve të nxjerra nga kryetari dhe kuvendi i komunës me qëllim të informimit të qytetarëve. Përfundim në këtë mes bënë vetëm Komuna e Gjakovës, e cila ka publikuar të gjitha vendimet e nxjerra nga Kuvendi i Komunës, mirëpo jo edhe ato të kryetarit të komunës. Komunitat e tjera, vetëm pjesërisht e kanë bërë publikimin e akteve të nxjerra nga Kuvendi i Komunës. Krahas kësaj, takime publike me qytetarë gjatë kësaj periudhe ka mbajtur vetëm Komuna e Rahovecit.

Sipas pikës (j) të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, kryetari i Komunës është i obliguar të raportoj para kuvendit të komunës për situatën ekonomiko-financiare të komunës dhe për zbatimin e planeve investuese të komunës, së paku njëherë në gjashtë muaj apo kurdoherë që kërkohet nga kuvendi i komunës. Në këto komunitat, ky obligim është përmbushur nga kryetarët e Komunave: Gjakovë, Junik, Deçan dhe Istog. Kurse, në Komunën e Rahovecit, kryetari i komunës, deri në muajin mars të vitit 2013 nuk ka raportuar para Kuvendit të Komunës.

Gjatë kësaj periudhe, informimi dhe komunikimi me organin mbikëqyrës, përkatësisht Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal nuk ka qenë i rregullt në të gjitha rastet. Megjithatë në shumicën e rasteve ftesa për mbledhjet e kuvendit është dërguar me kohë, kjo nuk ka ndodhur edhe për materialet e mbledhjeve të kuvendit. Në shumë raste komunitat nuk i kanë dërguar paraprakisht materialet e mbledhjeve të kuvendit tek zyrtarët monitorues të MAPL-së, edhe pse kjo është obligim ligjorë i komunave. Po ashtu, në mbarëvajtjen e sistemit të teleprezencës, janë shfaqur pengesa në disa raste në Komunën e Deçanit dhe në vazhdimësi në Komunën e Junikut¹.

Sa i përket krijimit të kushteve për shqyrtimin administrativ të akteve komunale nga organet mbikëqyrëse si formë e veçantë e autorizimeve kontrolluese, dërgimi i akteve komunale nuk ka qenë i rregullt nga këto komunitat. Edhe më tej, Komuna e Rahovecit nuk ka dërguar aktet për vlerësim të ligjshmërisë. Në këtë mes përfshihet edhe Komuna e Deçanit, e cila nuk ka arritur të ndërtoj një sistem standard të dërgimit të akteve komunale. Për dallim nga to, Komuna e Gjakovës, Junikut dhe Istogut, kanë treguar praktikë të mirë në dërgimin e akteve komunale duke përfshirë edhe shfrytëzimin e

¹ Për më tepër, në pjesën e veçantë të raportit

mundësisë së konsultimit paraprak, para nxjerrjes së akteve juridike komunale. Megjithatë, në këtë periudhë janë konstatuar 4 raste të shkeljeve ligjore, prej të cilave dy raste në Rahovec, 1 në Deçan dhe 1 në Istog. Prej këtyre rasteve, vetëm Komuna e Istogut ka marrë parasysh rekomandimet e komisionit përkatës ndërministror duke harmonizuar aktin sipas rekomandimeve të dhëna. Ndërkaq, prej vendimeve të cilat janë miratuar në vitin 2012 për të cilat janë konstatuar shkelje ligjore, në vitin 2013 për të evituar jo-ligjshmërinë, Komuna e Rahovecit ka rishqyrtuar dy akte të kundërligjshme (të cilat i ka shfuqizuar), si dhe një vendim Kuvendi i Komunës së Gjakovës, të cilin e ka harmonizuar sipas rekomandimeve të MAPL-së.²

Aspekt tjetër i rëndësishëm për t'i përmbledhur në këtë pjesë të raportit është edhe puna e mekanizmave konsultativ në fushën e sigurisë. Mekanizëm i tillë siç dihet është edhe Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, i cili themelohet në kuvendin e komunës ndërsa kryesohet nga kryetari i komunës. Me U.A. Nr.27/2012 MPB - 03/2012 MAPL për KKSB është përcaktuar numri prej gjashtë mbledhjeve brenda vitit të këtij mekanizmi. Sipas të dhënave, në këto komuna KKSB ka zhvilluar numrin e mëposhtëm të takimeve:




Fig. 12. Numri i takimeve të KKSB-ve në komunat: Gjakovë, Deçan, Junik, Istog dhe Rahovec

Nga figura e mësipërme vërejmë se KKSB ka mbajtur takime në Komunën e Junikut, Rahovecit dhe Istogut, përderisa në Komunën e Gjakovës dhe të Deçanit nuk ka mbajtur asnjë takim.

Në këtë periudhë, në pajtim me Udhëzimin administrativ për KKSB është miratuar përbërja e re e KKSB-së në Komunën e Deçanit. Në vitin e kaluar përbërja e re e KKSB-së ishte miratuar në Gjakovë dhe Istog, andaj sipas kësaj mbetet që ndryshimi i këtij mekanizmi konform rregullativës së re ligjore të plotësohet në Komunën e Junikut dhe Rahovecit.

² Po aty

Pjesa e veçantë

Në këtë pjesë të raportit janë pasqyruar disa nga të gjeturat e evidentuara në komunat e mëposhtme si dhe veprimet e komunave për evitimin e joligjshmërisë:

Junik

1) Gjatë periudhës janar-mars, në Komunën e Junikut nuk është monitoruar asnjë mbledhje e Kuvendit të Komunës, për shkak të mosdërgimit të aplikacionit nga komuna për lidhje në sistemin e teleprezencës. Në këtë komunë, mjetet e teleprezencës nuk janë menaxhuar sipas rregullave të nenit 7 të Udhëzimit Administrativ nr. 2012/01 për Monitorimin e Kuvendeve të Komunave përmes pajisjeve të teknologjisë informative “Teleprezencave”.

Rahovec

1) Në Komunën e Rahovecit, një numër i rasteve të shkeljeve ligjore kanë mbetur nga viti i kaluar dhe nuk janë rishqyrtuar sipas rekomandimeve të institucionit mbikëqyrës. Prej rasteve të cilat janë bartur nga viti 2012 në këtë periudhë, Komuna e Rahovecit ka rishqyrtuar dhe shfuqizuar vetëm dy vendime që kanë të bëjnë me dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, njëri për tregjet dhënë shoqatave të luftës si dhe tjetri për deponinë e mbeturinave të ngurta po ashtu dhënë shoqatave të luftës.

2) Në periudhën janar-mars 2012, MAPL ka konstatuar se procedurat e ndjekura me rastin e nxjerrjes së Vendimit për themelimin e Komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale nuk kanë qenë në harmoni me dispozitat e Ligjit nr.04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës. Më konkretisht nuk është respektuar paragrafi 3 i nenit 8 të këtij ligji, sipas të cilit, “propozimi për anëtarët e Komisionit aprovohet në Kuvendin e Komunës me shumicën e votave të anëtarëve të Kuvendit”. Me rastin e themelimit të këtij Komisioni, Kuvendi i Komunës së Rahovecit ka miratuar vetëm përbërjen e tre anëtarëve të propozuar nga Kuvendit i Komunës, ndërsa jo edhe përbërjen e Ekzekutivit të Komunës dhe shoqërisë civile, pasi që nuk ishin dhënë propozimet. Për këtë vendim, MAPL ka bërë shkresë me të cilën është kërkuar rishqyrtimi i këtij vendimi dhe miratimi i tërësishëm i përbërjes së Komisionit për vlerësim të ofertave në Kuvendin e Komunës, mirëpo Komuna e Rahovecit nuk ka marrë parasysh kërkesën për rishqyrtim të aktit.

4) Sipas vlerësimit të Komisionit të përbashkët MF/MAPL, Rregullorja për taksa, tarifa dhe gjoba e miratuar në Kuvendin e Komunës së Rahovecit, duhet të harmonizohet me legjislacionin në fuqi. Kjo rregullore ka kaluar disa herë në shqyrtim të këtij komisioni, megjithatë ende Komuna e nuk i ka inkorporuar ndryshimet e kërkuara nga ky Komision. Disa nga të gjeturat për këtë rregullore janë: Neni 13 tabela (b) e Rregullores

është në kundërshtim me U.A. 2006/1 të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, meqë kjo është kompetencë e deleguar e Komunave dhe rregullimi i kësaj materie duhet të bëhet vetëm konform dispozitave të cilat i përmban udhëzimi i Agjencisë Kadastrale të Kosovës. Neni 17 i Rregullores i cili rregullon taksat në fushën e shëndetësisë duhet të harmonizohet me Shtojcën 1 (a) për bashkëpagesat për shërbimet shëndetësore të nivelit parësor, konform U.A. 04/2007 për Mbledhjen dhe Shfrytëzimin e Mjeteve nga Bashkëpagesat e Shfrytëzuesve për Shërbimet Shëndetësore. Shkresa e fundit e cila dërguar për këtë Rregullore, është ajo e datës 04.03.2013 me të cilën kërkohet të përfshihen rekomandimet e përshkruara më lartë. Ende komuna e Rahovecit nuk e ka ndryshuar këtë Rregullore sipas rekomandimeve të komisionit sektorial.

5) Lidhur me krijimin e kushteve për shqyrtimin administrativ të akteve komunale nga organi mbikëqyrës, është evident fakti që Komuna e Rahovecit nuk i është përmbajtur përgjegjësi të cilat rrjedhin nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale. Edhe gjatë kësaj periudhe, kjo komunë aktet e miratuara në kuvendin e Komunës, nuk i ka dërguar për shqyrtim të ligjshmërisë.

Gjakovë

1) Kuvendi i Komunës së Gjakovës mbi bazën e kërkesës së komisionit përkatës ndërmintor MAPL-MBPZHR, ka bërë rishqyrtimin e vendimit të Kuvendit të Komunës së Gjakovës me nr.011-864-2012 i miratuar me datë 02.02.2012 për plotësimin e vendimeve mbi caktimin e tokës ndërtimore urbane dhe në zonën ndërtimore të qytetit të Gjakovës. Me këtë rast është bërë plotësim-ndryshimi i vendimit të mëparshëm për caktimin e tokës ndërtimore, mirëpo edhe ky vendim është kundërshtuar përsëri nga Komisioni sektorial. Me këtë rast Komuna e Gjakovës me një shkresë e konteston vlerësimin e Komisionit sektorial për rastin në fjalë duke parashtruar argumentet se me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Gjakovës 01.nr 011-606/2013 , janë respektuar dispozitat e Ligjit për Planifikim Hapësinor nr 2003/14, Pjesa 2, Kreu I, përkatësisht neni 13 , paragrafët 13 .1 dhe 13.9 dhe neni 14 paragrafi 14.6 , lidhur me nenin 17 (b) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040

2) Kuvendi i Komunës së Gjakovës mbi bazën e shkresës së MAPL-së me Nr.0204-1328, ka rishqyrtuar Vendimin me nr.011-5559 për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale në sipërfaqe prej 78 ari, me qëllim të realizimit të projektit për riciklimin e mbeturinave të financuar nga kompania CSG dhe "Green Energy" me qendër në Prishtinë. Për këtë rast Vendimi 01 Nr.011-1812 I natës 25.03.2013 për ndryshimin e Vendimit me nr.011-5559, i jep në shfrytëzim Kompanisë në fjalë pronën e paluajtshme komunale në shfrytëzim, pa zhvillim të procedurave konkurruese duke u thirrur në pikën 1 të paragrafit 1 të nenit 10 të Ligjit Nr. 04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, i cili parasheh që Procedurat e konkurrimit nuk

zbatohen për rastet e dhënies së pronës e paluajtshme të Komunës në shfrytëzim me qëllim të realizimit të investimeve në sektorin e energjisë.

Mirëpo, duhet përmendur që përveç prodhimit të energjisë termike, projekti i Kompanisë në fjalë përfshinë edhe veprimtarinë afariste të riciklimit të mbeturinave. Ende nuk është dhënë vlerësimi përfundimtar i vendimit të fundit për këtë çështje.

Deçan

1) Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me datë 29.03.2013 ka nxjerrë Vendim për miratimin e kërkesës së Kompanisë CEO,FAX Marble Holdings Plc për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim për vendosjen e fabrikës për përpunimin final të gurëve të dimensionuar.

Nxjerrja e Vendimit për miratimin e kërkesës së Kompanisë CEO, FAX Marble Holdings Plc për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim për vendosjen e fabrikës për përpunimin final të gurëve të dimensionuar, është vendim i nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit nr. 04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Çdo dhënie e pronës së komunës në shfrytëzim për raste të veçanta jashta specifikave të përcaktuara në dispozitat e nenit 10 të Ligjit nr. 04/l-144 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, nënkupton veprime dhe nxjerrje të vendimeve të kundërligjshme.

2) Gjatë kësaj periudhe Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me datë 29.03.2013 ka nxjerrë vendim për shfuqizimin e vendimit për kushtëzimin e regjistrimit të automjeteve me paraqitjen e dëshmisë për kryerjen e obligimeve ndaj NP "Ujësjetësi". Shfuqizimi i këtij vendimi është kërkuar me kërkesën e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

Istog

Ndër aktet e miratuara në Komunën e Istogut, Komisioni sektoriale MF-MAPL ka shqyrtuar Rregulloren për tarifa, ngarkesa dhe gjoha të kësaj komune. Për këtë Rregullore, ky Komision ka konstatuar se: fusha 5 - Drejtoria për Shëndetësi, Mirëqenie Sociale dhe Çështje Invalidore, pika 5.2.3 dhe 5.2.5 nuk është në harmoni me U.A. Nr 04/2007 të Ministrisë së Shëndetësisë, duke vlerësuar se në këtë Rregullore parashihen taksa më të larta se kufiri i lejuar.

Kjo rregullore është rishqyrtuar dhe miratuar sipas rekomandimeve të dhëna nga Komisioni sektorial.

KOMUNAT: FERIZAJ, KAÇANIK, SHTIME, FUSHËKOSOVË, MALISHEVË DHE MAMUSHË

Mbledhjet e mbajtura

Komunat Ferizaj, Kaçanik, Shtime, Fushë Kosovë, Malishevë dhe Mamushë, gjatë periudhës janar-mars të vitit 2013 kanë mbajtur 18 mbledhje të kuvendeve të komunave. Në vijim kemi paraqitur figurën e mbledhjeve të kuvendeve të komunave:

Kuvendet e Komunave




Fig.13. Numri i mbledhjeve të Kuvendeve të Komunave: Ferizaj, Kaçanik, Shtime, Fushë Kosovë, Malishevë, Mamushë;

Siç shihet nga figura e mësipërme, kuvendet e këtyre komunave kanë mbajtur rregullisht mbledhjet e kuvendeve të tyre. Prej 17 mbledhjeve të rregullta, vetëm një ka qenë e jashtëzakonshme dhe atë në Komunën e Kaçanikut.

Sa u përket komiteteve obligative, në këto komuna, me përjashtim të komitetit për komunitete të Komunës së Kaçanikut, në komunat e tjera KPF dhe KK kanë funksionuar me rregull. Sa i përket Komiteti për Politikë dhe Financa, në total janë mbajtur shtatëmbëdhjetë mbledhje të këtij komiteti, ndërkaq njëtrajtshëm me KPF-në, është mbledhur edhe Komiteti për komunitete, me përjashtim të Kaçanikut. Në vijim, është paraqitur figura krahasuese për numrin e takimeve të komiteteve të obligueshme:

Komitetet e obligueshme




Fig.14. Numri i mbledhjeve të Komiteteve të obligueshme: Ferizaj, Kaçanik, Shtime, Fushë Kosovë, Malishevë, Mamushë

Të gjitha mbledhjet e kuvendeve të komunave kanë qenë të hapura për publikun. Informimi i qytetarëve në vazhdimësi është bërë përmes ueb-faqes zyrtare të komunës, shpalljeve publike të vendosura në objektet e komunës, por edhe përmes mjeteve të informimit si televizioneve lokale dhe radiove lokale.

Sa i përket informimit dhe komunikimit me organin mbikëqyrës, përkatësisht Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal këto komunat qëndrojnë mirë në këtë drejtim. Gjatë kësaj periudhe ftesat për mbledhjet e kuvendit se bashku me materialet që kanë pasur të shqyrtohet në mbledhje të kuvendeve kanë arritur me kohë, pra është respektuar Ligji për vetëqeverisje lokale konkretisht neni 43.5 në lidhje me informimin dhe dërgimin e ftesës dhe materialit për mbledhje Ministrisë së Administrimit të pushtetit lokal. Monitorimi i mbledhjes së Kuvendeve të Komunave është bërë përmes sistemit të teleprezencës i cili sistem ka funksionuar normalisht dhe nuk kemi pasur probleme në qasjen direkt në përcjelljen e mbledhjeve të kuvendeve në komuna.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm për t'u elaboruar dhe që lidhet direkt me mandatin ligjor të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal është shqyrtimi administrativ i akteve komunale. Meqenëse MAPL-është autoritet mbikëqyrës i komunave, këto të fundit janë të obliguara që konform neni 80 të LVL-së të përcjellin aktet e miratuara nga kuvendi për shqyrtim të ligjshmërisë. Edhe në këtë aspekt këto komuna kanë treguar efikasitet dhe të gjitha vendimet si dhe rregulloret e miratuara në kuvend i kanë dërguar më kohë për shqyrtim të ligjshmërisë.

Lidhur me aktet komunale, në këtë periudhë janë miratuar gjithsej 50 akte, prej të cilave 47 vendime dhe 3 rregullore.

Aktet komunale




Fig. 15. Numri i akteve komunale të miratuara në Kuvendet e Komunave: Ferizaj, Kaçanik, Shtime, Fushë-Kosovë, Malishevë dhe Mamushë.

Në miratimin e akteve komunale, siç kemi paraqitur edhe në figurën e më sipërme, shihet që Kuvendi i Komunës së Ferizajt ka miratuar 14 vendime dhe një rregullore, Shtimja 13 vendime, Kaçaniku 9 vendime dhe një rregullore, Malisheva 6 vendime, Fushë-Kosova 5 vendime dhe 1 rregullore dhe Mamushë 4 vendime.

Aktet komunale të cilat janë nxjerrë në këtë periudhë i përkasin çështjeve të ndryshme nga kompetencat vetanake të komunave. Kësisoj, janë veçuar sidomos vendimet për shpalljen me interes të përgjithshëm të pronave, është bërë bartja e të hyrave vetanake nga viti fiskal 2012 në vitin 2013 (Ferizaj), janë miratuar një numër i planeve rregullative, vendime për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale bazuar ne Ligjin për dhënie ne shfrytëzim të pronës komunale, formimi i komisionit për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale (Ferizaj) etj.

Ndër vendimet e miratuara janë: Vendimi për shpalljen në diskutim publik propozimet e komisionit për emërtimin e rrugëve (Shtime); Vendimi për diskutim publik të Propozim-rregullores për procedurat e themelimit dhe funksionimit të Këshillit të Veprimit Rinor Lokal në Komunën e Shtimes (Shtime), Vendimi për diskutim publik të propozim-rregullores për fuqizimin dhe promovimin e vullnetarizmit në Komunën e Shtimes; Caktimi i lokacionit për ndërtimin e Palestrës sportive (Shtime); Vendimi për lejimin e mjeteve buxhetore për kompensimin e një pjese të shpenzimeve të udhëtimit të nxënësve me nevoja të veçanta dhe lejimin e mjeteve buxhetore për aktivitete kulturore (Shtime); Vendimi për themelimin e Komisionit për çështjen e BENAF-it (Malishevë); Vendimi për formimin e komisionit komunal të aksionarëve (Malishevë); Rregullorja për shërbime publike komunale (Fushë Kosovë); Vendimi për binjakëzimin e Komunës së Mamushës me Komunën e Karacabey nga Republika e Turqisë.

Aspekt tjetër i rëndësishëm për t'i përmbledhur në këtë pjesë të raportit është edhe fusha e sigurisë së përgjithshme të qytetarëve. Në këto komuna janë themeluar trupat këshillëdhënëse për siguri, të njohura si Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi.

Komitetet e obligueshme




Fig.16. Numri i takimeve të KKSB-ve në komunat: Ferizaj, Kaçanik, Shtime, Fushë-Kosovë, Malishevë dhe Mamushë.

Nga figura e mësipërme vërejmë se Komuna e Ferizajt, Shtimes, Fushë-Kosovës, Malishevës dhe Kaçanikut kanë mbajtur nga një takim gjatë këtij tre mujori ndërsa komuna e Mamushës ende nuk ka mbajtur asnjë takim.

Gjithashtu, duhet shtuar se Komuna e Ferizajt, Shtimes, Fushë-Kosovës, Malishevës dhe Kaçanikut i kanë marrë vendimet në kuvend për themelimin e KKSB-ve konform udhëzimit administrative numër 27/2012 MPB-03/2012 MAPL, për themelimin e këtyre këshillave ndërsa komuna e Mamushës ende nuk e ka miratuar një vendim të tillë për themelimin e KKSB-ve në këtë komunë konform UA. Sipas të dhënave, KKSB, në këto komuna kanë mbajtur këtë numër të takimeve:

Pjesa e veçantë

Në këtë pjesë të raportit janë pasqyruar disa nga të gjeturat e evidentuara në komunat e mëposhtme si dhe veprimet e komunave për evitimin e joligjshmërisë:

Ferizaj

1) Në Kuvendin e Komunës së Ferizajt është shprehur iniciativa e anëtarëve të PDK-së për shkarkimin e kryesuesit të Kuvendit, pasi që kryesuesi ka ndërruar subjektin politik. Në mbledhjen e kuvendit të mbajtur me datën 28.02.2013, me propozimin e subjektit politik të PDK-së, si pikë e rendit të ditës është shqyrtuar "Votëbesimi i Kryesuesit të Kuvendit z. Xhavit Zariqi". Mirëpo, pas procesit të votimit të mbajtur konform procedurave ligjore, Kuvendi nuk ka arritur t'i mbledhë votat e mjaftueshme

për shkarkimin e tij. Ndërkaq, gjatë votimit të këtij propozimi për shkarkimin e kryesuesit, grupi parlamentar i LDK-së nuk ka marrë pjesë në votim.

2) Sipas vlerësimit të Komisionit të përbashkët MF/MAPL, është konstatuar se Komuna e Ferizajt ka miratuar Rregulloren për tarifa ngarkesa dhe gjoha komunale në kundërshtim me nenin 12 të Rregullores për Publikimin e akteve lokale.

Shkresa për te harmonizuar këtë rregullore me dispozitat ligjore të cilat rregullojnë këtë fushë, Komunës së Ferizajt i është dërguar më datën 06.03.2013, mirëpo komuna ende nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për ta ndryshuar këtë akt sipas rekomandimeve të komisionit në fjalë.

Kaçanik

1) Kuvendi i Komunës së Kaçanikut në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur më 11.02.2013, nuk ka respektuar Ligjin për vetëqeverisje lokale përkatësisht nenin 44.3 në të cilin shprehimisht thuhet se “pikat e caktuara në rendin e ditës për mbledhjet e jashtëzakonshme nuk mund të ndryshohen gjatë mbledhjes. Ndërsa, Kuvendi i Komunës së Kaçanikut gjatë mbledhjes ka shtuar piken për “Propozim-vendimin për lejimin e shumës prej 2149 euro për shënimin e 5 vjetorit të pavarësisë”.

Në lidhje me këtë rast, MAPL ka konstatuar se Kuvendi i Komunës së Kaçanikut ka bërë shkelje procedurale dhe me datën 22.02.2013 i kemi dërguar shkresë ligjore komunës së Kaçanikut me të cilën është kërkuar që kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut të ndërmerret të gjitha veprimet që mbledhja e jashtëzakonshme e KK të jetë në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

2) Në Komunën e Kaçanikut, Komiteti për Komunitete është i themeluar, mirëpo gjatë kësaj periudhe ky komitet nuk ka qenë funksional dhe nuk ka mbajtur asnjë mbledhje.

Mamushë

1) Komuna e Mamushës ende nuk e ka miratuar vendimin për themelimin e KKSB-së konform U.A. Nr.27/2012 MPB - 03/2012 MAPL për themelimin e këtyre këshillave në komuna.

Shtime

1) Sipas vlerësimit të Komisionit të përbashkët MF/MAPL, Rregullorja për taksa, tarifa dhe gjoha e miratuar në Kuvendin e Komunës së Shtimes duhet të harmonizohet me UA nr. 2006/1 dhe UA nr. 2012/05 të AAK. Nga kjo Rregullore duhet të hiqet tatimi në pronë pasi që këtë fushë e rregullon Rregullorja e veçantë komunale. Edhe pse shkresa komunës i është dërguar me datën 05.02.2013, Komuna e Shtimes, këtë rregullore nuk e ka ndryshuar sipas rekomandimeve të komisionit sektorial.

Malishevë

Komisioni i përbashkët MF/MAPL ka shqyrtuar ligjshmërinë e Rregullores për taksë, tarifa, ngarkesa dhe gjoba të miratuar në Kuvendin e Komunës së Malishevës, duke e vlerësuar tërësisht të papranueshme për shkak të gjetjes së dispozitave të kundërligjshme dhe përcaktimin e dispozitave mbi dënimet dhe gjobat të cilat janë të vendosura në Rregulloren e Gjykatës për kundërvatje. Andaj, komisioni ka kërkuar që Komuna e Malishevës të hartoj një rregullore të re konform Ligjit nr.03/L-40 për vetëqeverisje lokale dhe Ligjit nr.03/L-049 për financat e pushtetit lokal, si dhe të gjitha Udhëzimet Administrative të nivelit qendror të cilat përcaktojnë taksat dhe tarifat administrative. Komisioni ka

Edhe pse shkresa komunës i ka shkuar më datën 04.02.2013, Komuna e Malishevës ende nuk e ka vepruar sipas rekomandimeve të komisionit sektorial.

KOMUNAT : VITI, OBILIQ HAN I ELEZIT, LIPJAN, PODUJEVË, KLINË, DRAGASH

Mbledhjet e mbajtura

Komunat: Viti, Obiliq, Han i Elezit, Lipjan, Klinë, Podujevë dhe Dragash gjatë periudhës janar-mars të vitit 2013, kanë mbajtur gjithsej 19 mbledhje të rregullta dhe 2 të jashtëzakonshme. Më detajisht kemi paraqitur figurën e mbledhjeve të Kuvendeve të Komunave, si vijon:

Kuvendet e Komunave




Fig. 17. Numri i mbledhjeve të Kuvendeve të Komunave: Viti, Obiliq, Han i Elezit, Lipjan, Podujevë, Dragash dhe Klinë.

Nga figura 1 vërejmë se numrin më të madh të mbledhjeve e ka mbajtur Kuvendi i Komunës së Obiliqit. Krahas kësaj edhe komunat e tjera qëndrojnë në të njëjtin ritëm të mbledhjeve, me përjashtim të Komunës së Vitisë e cila i ka mbajtur vetëm 2 mbledhje. Edhe komitetet për komunitete kanë qenë funksionale në këtë periudhë. Kësisoj, këto komitete kanë mbajtur këtë numër të takimeve, të elaboruar në vijim:

Komitetet e obligueshme




Fig. 18. Numri i mbledhjeve të Komiteteve të obligueshme: Viti, Obiliq, Han i Elezit, Lipjan, Podujevë, Dragash dhe Klinë.

Nga pasqyrimi i mësipërm shohim se edhe në mbajtjen e mbledhjeve të Komiteteve Komuna e Obiliqit ka treguar performancë më të mirë. Megjithatë, në të gjitha komunat funksionimi i këtyre komiteteve ka qenë i rregullt. Madje, nga figura shohim se Komiteti për Komunitete ka qenë ekuivalent me Komitetin për Politikë dhe Financa, për të cilën tregojnë të dhënat e takimeve.

Të gjitha mbledhjet e kuvendeve kanë qenë të hapura për publikun. Informimi i qytetarëve në vazhdimësi është bërë përmes ueb-faqes zyrtare të komunës, shpalljeve publike të vendosura në objektet e komunës, por edhe përmes televizioneve lokale. Ndërkohë, ajo që është vërejtur tregon se qytetarët nuk duken edhe aq të inkurajuar për të qenë pjesëmarrës në takimet e kuvendit. Madje, edhe tubimet publike të organizuara lidhur me çështjet e interesit të përgjithshëm, siç mund të jenë miratimi i rregulloreve apo planeve të ndryshme komunale, nuk i ka nxitur qytetarët për të qenë pjesëmarrës. Megjithatë, komunat janë kujdesur të respektojnë rregullat për njoftimin e qytetarëve me rastin e diskutimeve publike. Për më tepër, ueb-faqet zyrtare të komunave në vazhdimësi kanë qenë azhurnuara me informacione dhe aktivitetet e komunave, me përjashtim të Komunës së Obiliqit dhe Dragashit.

Gjatë kësaj periudhe janë miratuar gjithsej 55 akte komunale, prej të cilave 55 vendime dhe 5 rregullore.




Fig. 19. Numri i akteve të miratuara në Kuvendet e Komunave: Viti, Obiliq, Hani i Elezit, Lipjan, Podujevë, Dragash dhe Klinë.

Ndër vendimet e miratuara janë: Vendimi për pasqyrat financiare dhe bilancin e gjendjes për periudhën janar-dhjetor 2012 (Viti); Vendimi për formimin e Komisionit për koordinimin e punës për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillave lokale dhe Kryetarëve të Këshillave lokale të fshatrave dhe lagjeve të qytetit të Vitisë; Miratimi i nismës për bashkëpunimit komunal ndërkombëtar - binjakëzim me Qytetin Eësterstede në

Gjermani (Podujevë); Rregullorja për barazi gjinore (Hani i Elezit); Planit i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (Hani i Elezit); Vendimi për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, sipas U.A. Nr.27/2012 MPB - 03/2012 MAPL për KKSB (Klinë dhe Dragash); Vendimi për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës në pronësi të Komunës (Dragash); Themelimi i Komisionit për vlerësimin e ofertarve me rastin e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale (Dragash); Vendimi për shpalljen në shqyrtim publik të Draft Planit për plotësimin dhe ndryshimin e Planit Zhvillimor Komunal dhe Planit Zhvillimor Urban (Lipjan); Rregullorja për caktimin e qirasë për dhënien në shfrytëzim të tokës bujqësore, banesave dhe lokaleve afariste në pronësi të Komunës (Lipjan); Rregullorja për transportin e rregullt urbano - periferik të udhëtarëve me autobus (Lipjan); Vendimi për miratimin e iniciativës mbi vendosjen e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar me Prefekturën e Gjirokastrës së Republikës së Shqipërisë (Lipjan).

Sa i përket informimit dhe komunikimit me organin mbikëqyrës, përkatësisht Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal komunat qëndrojnë relativisht mirë në këtë drejtim. Në shumicën e rasteve ftesa për mbledhjet e kuvendit ka arritur me kohë, mirëpo jo të gjitha komunat dërgojnë materialet e mbledhjeve të bashkangjitur me ftesë. Për më saktë, është Komuna e Dragashit ajo e cila nuk i ka dërguar materialet e mbledhjeve në mënyrë elektronike.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm për t'u elaboruar dhe që lidhet direkt me mandatin ligjor të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal është shqyrtimi administrativ i akteve komunale. Ky lloj i shqyrtimit nënkupton shqyrtimin e rregullt të ligjshmërisë së akteve komunale, për të cilat akte ligji nuk ka përcaktuar në kompetencë të ndonjë ministrie tjetër të realizoj atë. Në këtë drejtim, komunat: Viti, Obiliq, Klinë, Hani i Elezit, Lipjan, Podujevë dhe Dragashi e kanë respektuar këtë obligim ligjor duke dërguar me rregull të gjitha aktet e kuvendeve të komunave për shqyrtim të ligjshmërisë.

Aspekt tjetër i rëndësishëm për t'i përmbledhur në këtë pjesë të raportit është edhe fusha e sigurisë së përgjithshme të qytetarëve. Në këto komuna kanë qenë funksionale trupat këshillëdhënëse për siguri, përkatësisht Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi. Sipas të dhënave, këto këshilla në këtë periudhë kanë mbajtur këtë numër të takimeve:

KKSBB




Fig. 20. Numri i takimeve të KKSBB-ve në komunat: Viti, Obiliq, Hani i Elezit, Lipjan, Podujevë, Dragash dhe Klinë.

Nga figura e mësipërme vërejmë se në Komunën e Vitisë, Obiliqit, Podujevës KKSBB-ja ka realizuar vetëm një takim, ndërkohë tri komunat: Kinë, Dragash dhe Lipjan kanë mbajtur nga dy mbledhje, ndërsa tri mbledhje ka mbajtur Komuna e Hanit të Elezit. Në përgjithësi, mund të themi se komunat nuk i kushtojnë rëndësinë e duhur Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.

Pjesa e veçantë

Në këtë pjesë të raportit janë pasqyruar disa nga të gjeturat e evidentuara në komunat e mëposhtme si dhe veprimet e komunave për evitimin e joligjshmërisë:

Vitia

1) Komuna e Vitisë në këtë periudhë ka miratuar vendimin mbi bartjen e të drejtës së shfrytëzimit të paluajtshmërisë (tokë) në pronësi shoqërore pronë e Komunës së Vitisë në shfrytëzuesin e përkohshëm Bashkësia Islame në Viti, për çerdhen e fëmijëve në Fshatin Dobrosh.

Ky vendim është vlerësuar si vendim i kundërligjshëm, për faktin se Bashkësia Islame nuk mundet të tjetërsoj të drejtën e dhënë nga komuna për shfrytëzimin e pronës e për të cilën synon të ndërtoj një Çerdhe në fshatin Dobrosh.

Podujeva

1) Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur me dt. 28.02.2013 ka miratuar vendimin për shndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore për parcelën kadastrale nr.61-2, kultura arë e klasit të 5. Ky vendim në preambulën e tij duhet të përmirësohet (jo bazuar në nenet 11.7 dhe 13.2 të Ligjit 02L/-26 për Tokën Bujqësore sepse këto nene e përcaktojnë ndërrimin e përkohshëm të tokës bujqësore në

atë jo bujqësore), por duhet të jetë e përcaktuar sipas nenit 44 paragrafi 44.1 Ligjit 02L/-26 për Tokën Bujqësore.

2) Gjithashtu në këtë mbledhje është miratuar edhe vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e shtëpive individuale për familjet e vendosura në lagjen e Kuvajtit në Balloc. Edhe ky vendim është cilësuar si jo i ligjshëm nga MAPL-ja.

3) Në mbledhjen e muajit mars kemi bojkotimin mbledhjes nga opozita me arsyetimin se nuk u përfill kërkesa e tyre për ta shtyre për mbledhjen e radhës Raportin financiar për vitin 2012. Pas bojkotimit të mbledhjes nga opozita kuvendi filloj punimet e tij ku më pas miratoj raportit financiar për vitin 2012, si dhe miratimin vendimit për përcaktimin në interes publik të një pjese të tokave të ish Ndërmarrjeve Shoqërore në territorin e Komunës së Podujevës.

Dragash

1) Kuvendi i Komunës së Dragashit në mbledhjen e mbajtur me dt. 31.01.2013 ka bërë shkelje të dispozitave të nenit 44.3 të LVL. Sipas dispozitave të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, përkatësisht nenit 44.3 “pikat e përcaktuara në rendin e ditës për mbledhjet e jashtëzakonshme nuk mund të ndryshohen gjatë mbledhjes”.

Obiliqi

1) Në mbledhjen e parë të mbajtur më 25.01.2013, Kuvendi i Komunës së Obiliqit ka diskutuar për projektin e ngrohjes së qytetit nga TC „Kosova B”. Anëtarët e kuvendit gjatë diskutimit të tyre shtruan nevojën se me ndryshmin e trasesë së ngrohjes, duhet të përfitoj edhe Komuna e Obiliqit, meqenëse traseja kalon nëpër territorin e Komunës së Obiliqit. Kjo ishte një çështje mjaft kontestuese, mirëpo në mënyrë unanime u miratua Vendimi me të cilin obligohet ekzekutivi i komunës që të bashkëpunoj me institucionet e projektit të ngrohjes së qytetit i cili do të kyçet nga termocentrali “Kosova B”, me kusht që të mos lëshohet leje pune për këtë projekt, derisa të arrihet marrëveshja nga të dy palët dhe institucionet që financojnë këtë projekt. Me këtë vendim po ashtu është kërkuar që gjithësesi në projekt të përfshihet edhe qyteti i Obiliqit si shpërblim për të gjitha dëmet që i shkaktohen kësaj Komune.

Për këtë rast, MAPL është drejtuar me shkresë me të cilën Vendimi i lartpërmendur është cilësuar i kundërligjshëm dhe është kërkuar që Komuna të rishqyrtoj këtë vendim, me arsyetimin se Kuvendi i Komunës së Obiliqit ka bërë shkelje të dispozitave të nenit 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale. Siç dihet kuvendi i komunës nuk ka kompetencë ligjore, për të obliguar administratën komunale, përkatësisht Drejtorin e Komunale për Pronë, Urbanizëm, Kadastër dhe Planifikim për mos lëshimin e lejeve të punës, në rast se plotësohen kushtet ligjore sipas procedurës administrative.

Në mbledhjen e Kuvendit të Komunës të mbajtur në muajin mars, është diskutuar kërkesa e MAPL-së për shfuqizimin e Vendimit të mbledhjes datës 25.01.2013, por Kuvendi i Komunës nuk ka marrë për bazë kërkesën në fjalë duke rikonfirmuar qëndrimin e mëparshëm për këtë çështje.

KOMUNAT: MITROVICË, VUSHTRRI, SKENDERAJ, SUHAREKË, GLOGOC

Mbledhjet e mbajtura

Gjatë kësaj periudhe janar-mars 2013, komunat Mitrovica, Skenderaj, Glogoc, Vushtrri, Suhareka kanë mbajtur një numër të konsiderueshëm të mbledhjeve. Gjatë kësaj periudhe kanë mbajtur gjashtëmbëdhjetë mbledhje të rregullta dhe një të jashtëzakonshme.

Më detajisht kemi paraqitur figurën e mbledhjeve të Kuvendeve të Komunave.

Kuvendet e Komunave




Fig.21. Numri i mbledhjeve të mbajtura në Komunat: Mitrovicë, Skenderaj, Vushtrri, Glogoc, Suharekë

Në figurën e mësipërme shihet se Kuvendi i Komunës së Mitrovicës ka mbajtur tri mbledhje të rregullta dhe një të jashtëzakonshme, Vushtrria, Skenderaj, Glogoci dhe Suhareka kanë mbajtur nga tri mbledhje të rregullta dhe asnjë të jashtëzakonshme.

Edhe komitetet për komunitete kanë qenë funksionale në këtë periudhë. Kësisoj, këto komitete kanë mbajtur këtë numër të takimeve, të elaboruar në vijim:

Komitetet e obligueshme




Fig. 22. Numri i mbledhjeve të Komiteteve të obligueshme: Mitrovicës, Vushtrrisë, Skenderaj, Glllogoc, Suharekë

Nga figura e mësipërme shihet se këto komitete kanë qenë funksional gjatë kësaj periudhe, numri i mbledhjeve është përafërsisht i njëjtë në të gjitha këto komuna.

Këto Komuna, janë brenda dinamikës të punës të mbajtjes së mbledhjeve , ashtu siç parashihet me LVL. Ftesat dhe materialet për mbledhje nga këto komuna, janë dërguar me kohë dhe në përputhje me nenin 43 të LVL-së. Rrjedha e punës së Kuvendeve të këtyre Komunave, është shoqëruar me diskutime konstruktive, si nga opozita por edhe pozita, për ato pika të rendit të ditës të cilat kanë qenë më me prioritet për qytetarin, ku mundë të thuhet se respektohet Rregullorja e Punës së Kuvendit. Mbledhjet e mbajtura kanë qenë transparente për publikun. Si shembull i mirë mund të merret Komuna e Suharekës, e cila me qëllim të rritjes së transparencës në komunë dhe qasjen e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes, ka filluar të publikoj aktivitet e komunës në dy ekranet e mëdha të vendosura në hollin e komunës.

Zakonisht në takimet e kuvendeve të komunave është vërejtur prezenca e shoqërisë civile, mjeteve të informimit si dhe e qytetarëve. Informimi i qytetarëve për mbledhje apo ndonjë aktivitet të Komunës bëhet përmes shpalljeve publike dhe ueb faqes së Komunës.

Gjatë kësaj periudhe, ajo çka i ka përcjellë kuvendet e këtyre komunave është edhe raportimi i kryetarëve të komunave për vitin 2012, lidhur me situatën ekonomiko financiare dhe për zbatimin e planeve investuese në komuna.

Aktet komunale




Fig. 23. Numri i akteve komunale të miratuara në Kuvendet e Komunave: Mitrovicë, Skenderaj, Vushtrri, Glllogoc, Suhareka.

Nga të dhënat e paraqitura më lartë, mundë të konkludojmë se këto komuna gjatë kësaj periudhe kanë qenë mjaft aktive në nxjerrjen e akteve komunal. Këtu vërehet se Komuna e Mitrovicës ka miratuar 23 vendime dhe 11 rregullore, Glllogoci 16 vendime dhe 1 rregullore, Skenderaj 12 vendime, Suhareka 12 vendime dhe 1 rregullore si dhe Vushtrria 16 vendime dhe 1 rregullore.

Aktet komunale të nxjerra rregullojnë fusha të ndryshme që dalin nga kompetencat vetanake të komunave. Kësisoj në Komunën e Mitrovicës është nxjerrë Rregullorja për Mbrojtjen nga Zjarri, Rregullorja për Mbrojtjen e të Miturve nga Dukurit Negative, si dhe Rregullore për vetëdijesimin dhe marrjen e masave preventive për parandalimin e dukurive negative, të gjitha të miratuara në Kuvendin e Komunës së Mitrovicës. Krahas kësaj komune, në Komunën e Vushtrrisë, është miratuar Rregullorja për procedurat e dhënies në shfrytëzim afat shkurtë të pronës komunale. Me qëllim të vënies së qytetarëve sa më afër vendimmarrje kjo komunë ka hartuar një Strategji për Informim, Komunikim dhe Pjesëmarrje të Qytetarëve e cila është në diskutim publik. Vendime për dhënien e pronave komunale në shfrytëzim po ashtu janë nxjerrë edhe nga Komuna e Skenderajt. Kurse, Kuvendi i Komunës së Glllogocit ka nxjerrë dhe harmonizuar Rregulloren për ndarjen e banesave, po ashtu ka miratuar Vendimin për përbërjen e anëtarëve të Komitetit Konsultativ për Mbrojtjen e Grave dhe të Fëmijëve me qëllim të pjesëmarrjes së qytetarëve në komitet konsultative kuvendi ka miratuara , vendim për pagesë e këtyre anëtarëve.

Në këto komuna nuk është evidentuar asnjë rast i shkeljeve ligjore me rastin e miratimit të akteve komunale nga Kuvendi i Komunës.

Gjatë kësaj periudhe, komuna kanë qenë mjaft aktive edhe sa i përket fushës së sigurisë së përgjithshme. Tani më komunat e kanë funksional Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi si trup konsultues për sigurinë në vend, i rregulluar edhe me U.A. Nr.27/2012 MPB - 03/2012 MAPL. Gjatë kësaj periudhe këto komuna kanë mbajtur këtë numër të mbledhjeve:




Fig. 24. Numri i takimeve të KKSB-ve në komunat: Mitrovicë, Skenderaj, Glllogoc, Vushtrri, Suharekë

Lidhur me obligimet që dalin nga U.A. për KKSB, gjatë kësaj periudhe në Komunën e Suharekës është nxjerrë Plani i Punës së KKSB-së për vitin 2013, ndërsa në Kuvendin e Komunës së Mitrovicës është nxjerrë vendimi për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi .

Pjesa e veçantë

Në këtë pjesë të raportit janë pasqyruar disa nga të gjeturat e evidentuara në komunat e mëposhtme si dhe veprimet e komunave për evitimin e joligjshmërisë:

Mitrovicë

Sipas vlerësimit të Komisionit të përbashkët MMPH/MAPL, Vendimin për plotësimin e vendimit të Kuvendit të Komunës Nr.01/06-22/7 të datës 26.09.2005, për ndarjen e banesave në ndërtesën “Kej Lushta” kuadrove të institucioneve të komunës së Mitrovicës nuk është referuar sipas dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, Ligjit për financimin e programeve të veçanta të banimit, si dhe udhëzimeve administrative që dalin nga ky ligj, ndërsa u është referuar gabimisht Ligjit mbi marrëdhëniet banesore të KSAK i cili nuk është në fuqi.

Edhe pse për këtë rast komunës i është dërguar shkresë me datën 14.03.2013, Komuna e Mitrovicës nuk e ka ndryshuar këtë Rregullore sipas rekomandimeve të komisionit sektorial.

Vushtri

Sipas vlerësimit të Komisionit të përbashkët MF/MAPL, është konstatuar se Komuna e Vushtrrisë bazuar në nenin 81.4 të Ligjit Nr. 03/L-40 për vetëqeverisje Lokale dhe Ligjin Nr03/L049 për financa të pushtetit lokal, Rregullorja për tarifa, ngarkesa dhe gjoba nga shërbimet dhe veprimtaritë komunale të komunës së Vushtrrisë duhet të harmonizohet me legjislacionin në fuqi, përkatësisht nenet 7.5, 31 dhe 39 pika 1,2,3,4, duhet të hiqen nga rregullorja.

Për të harmonizuar këtë rregullore konform legjislacionit në fuqi Komunës së Vushtrrisë është dërguar shkresë më datën 06.03.2013, ndërsa Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë me datën 04.04.2013, e ka harmonizuar rregulloren në përpudhje me kërkesën e Komisionit MF/ MAPL.

KOMUNAT: GRAQANICË, SHTËRPCË, RANILLG, PARTESH DHE KLLOKOT

Mbledhjet e mbajtura

Komunat: Graçanicë, Shtërpcë, Ranillg, Partesh dhe Kllokot gjatë periudhës janar-mars të vitit 2013, kanë mbajtur 15 mbledhje të kuvendeve të komunave. Prej tyre janë mbajtur 14 mbledhje të rregullta dhe 1 e jashtëzakonshme. Më detajisht në vijim kemi paraqitur figurën e mbledhjeve të Kuvendeve të Komunave:




Fig. 25. Numri i mbledhjeve të Kuvendeve të Komunave: Graçanica, Shtërpce, Ranillgu, Partesh dhe Kllokot.

Nga figura e sipërme, shihet se të gjitha komunat kanë mbajtur mbledhjet rregullisht. Mbledhjet e kuvendeve kanë qenë të hapura për publikun, ndërkaq informimi i qytetarëve në vazhdimësi është bërë përmes ueb-faqes zyrtare të komunës, shpalljeve publike të vendosura në objektet e komunës, por edhe përmes televizioneve lokale. Mirëpo, me gjithë se qytetarët janë ftuar, pjesëmarrja nuk ka qenë e madhe në mbledhje, gjë që tregon mosinteresimin e tyre për të qenë pjesëmarrës në takimet e kuvendeve.

Krahas kuvendeve të komunave, gjatë kësaj periudhe kanë funksionuar vetëm Komiteti për Politikë dhe Financa. Numri i mbledhjeve të komiteteve obligative është si në vijim:

Komitetet e obligueshme




Fig. 26. Numri i mbledhjeve të Komiteteve të obligueshme: Graçanicë, Shtërpcë, Ranillg, Partesh dhe Klllokot.

Nga pasqyrimi i mësipërm shohim se edhe Komiteti për Politik dhe Financa ka pasur rrjedh të punës normale, krahas Komiteti për Komunitete që nuk ka funksionuar. Komunitet kanë miratuar një numër të akteve komunale që shprehur në numër janë gjithsej 60 vendime dhe 2 Rregullore.

Aktet komunale




Fig. 3. Numri i akteve të miratuara në komunat: Graçanicë, Shtërpcë, Ranillg, Partesh dhe Klllokot.

Ndër aktet e miratuara në këtë periudhë janë: Vendimi për miratimin e “Planit akcional për ndarjen më të mirë të buxhetit për Komunën e Graçanicës për vitin 2013, Vendimi për ndarjen e tokës për ndërtimin e Kishës në Qagllavicë; Vendim për miratimin e propozimit të përbërjes së Komitetit për Siguri në Bashkësi në Komunën e Ranillugit. Vendimi për shpalljen e disa parcelave të interesit të përgjithshëm shoqëror (Ranillug);

Vendimi për ridestnim të mjeteve financiare nga të ardhurat vetanake në vlerë prej 9.000€ për projektin e ri kapital "Punimi dhe mbikëqyrja e projekteve kapitale për komunën Ranilugit; Rregullorja për dhënie në shfrytëzim të pasurisë së paluajtshme të Komunës përmes procedurës së ankandit publik (Kllokot); Ndryshimi dhe plotësimin e rregullores për transparence (Shtërpcë) etj.

Është për tu cekur se gjatë zhvillimit të punimeve të Kuvedneve të këtyre komunave, me përjashtim në Komunën e Kllokotit, në komunat e tjera kryetari i komunës nuk ka marrë pjesë asnjëherë në mbledhjet e kuvendit.

Sfidë tjetër mbetet edhe funksionalizimi i softuerëve për qasje në dokumentet zyrtare. Kështu, Graçanica, Parteshi, Kllokoti dhe Ranilugu duhet të punojnë në drejtim të aplikimit të programit për qasje në dokumente zyrtare.

Pjesa e veçantë

Në këtë pjesë të raportit janë pasqyruar disa nga të gjeturat e evidentuara në komunat e mëposhtme si dhe veprimet e komunave për evitimin e joligjshmërisë:

Graçanicë

1) Në Komunën e Graçanicës nuk është rezervuar pozita e nënkryetarit të komunës për komunitete, pozitë e cila parashihet me paragrafin 1 të nenit 61 të LVL-së, sipas të cilit Komunat ku të paktën 10% e qytetarëve i përkasin komuniteteve jo-shumicë do të kenë një nënkryetar për komunitete.

MAPL është drejtuar me shkresë të veçantë me të cilën ka kërkuar nga kryetari i Komunës së Graçanicës të propozoj në Kuvendin e Komunës emërimin e kryetarit të komunës për komunitete konform paragrafit 1 të nenit 61 të LVL-së.

2) Në këtë komunë, gjatë kësaj periudhe ka pasur probleme në konektimin e sistemit të teleprezencës për monitorimin e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

Parteshi

1) Sistemi i teleprezencë ka funksionuar me vështirësi pasi komuna është në fazën e kalimit në objektin e ri. Materiali dhe ftesat për takime janë dërguar me kohë, por dokumentet nuk janë përkthyer në gjuhën shqipe.

Shtërpcë

1) Megjithëse salla e Kuvendit të Komunës në Shtërpcës është modernizuar me pajisje të reja, problem mbetet përkthimi nga gjuha shqipe në gjuhën serbe.

REKOMANDIMET E PËRGJITHSHME

1. Komunat të njoftojnë me kohë MAPL-në për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendeve të komunave, ashtu siç është përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.
2. Të mirëmbahen dhe funksionalizohen pajisjet elektronike për monitorim të mbledhjeve të Kuvendeve të Komunave dhe vendosen konform U.A Nr. 2012/01 për monitorimin e kuvendeve të komunave përmes pajisjeve të teknologjisë informative “Teleprezencave”.
3. Të zbatojnë praktikatat më të mira për shpërndarjen e informatave për mbledhjet e kuvendit të komunës, duke përdorur format më efikase për informimin e qytetarëve.
4. Komunat të vazhdojnë me dërgimin e akteve të Kuvendeve të Komunave në MAPL për vlerësim të ligjshmërisë, konform nenit 80.1 të LVL-së.
5. Të respektohen kërkesat e MAPL-së për rishqyrtim të akteve në afatin e paraparë ligjor.
6. Komunat të shfrytëzojnë mundësinë e konsultimit paraprak.
7. Të respektohen parimet, kriteret dhe procedurat ligjore me rastin e miratimit të akteve juridike nënligjore, e në veçanti të respektohen procedurat ligjore për dhënien së pronës komunale në shfrytëzim.
8. Kuvendet e komunave të harmonizojnë konstituimin e KKSB-së konform U.A. Nr.27/2012 MPB - 03/2012 MAPL për KKSB.
9. Të respektohen dispozitat ligjore lidhur me dërgimin e procesverbaleve nga mbledhjet e KKSB-ve në MAPL dhe MPB sipas U.A. të lartpërmendur.